



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3767/ 7 prot

Datë 16.01.2025

V E N D I M
Nr. 80/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.01.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Arteo 2018” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” me Nr. REF-31091-11-26-2024, me objekt “Blerje pajisje zjarrfikëse” me fond limit: 1,191,441 (një milion e njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e katërqind e dyzet e një) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 11.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mat.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Mat
Adresë: Sheshi “Kastriotët”, Nr.1, KP 8001, Burrel.

Ankimues: Operatori ekonomik “Arteo 2018” SHPK me NIPT L82523203F, me adresë: Lagjia “Luigj Gurakuqi”, Blv “Aqif Pasha”, Hotel Skampa, Kati 5, Nr. 303, Elbasan.

Subjekt i Interesuar: Operatori ekonomik “Mbrotjtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” SHPK me NIPT L62102007V, me adresë: Rruga “Artan Lenja”, Hyrja Nr.1, Nr.Pasurie 1/301-N3, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 27.11.2024 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” me Nr. REF-31091-11-26-2024, me objekt “Blerje pajisje zjarrfikëse” me fond limit: 1,191,441 (një milion e njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e katërqind e dyzet e një) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 11.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mat.

II.2. Në datën 11.12.2024 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 13.12.2024 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1- “Arteo 2018” SHPK	1,061,000	lekë	skualifikuar
2- “Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” SHPK	1,107,000	lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 13.12.2024 operatori ekonomik “Arteo 2018” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, Shoqëria “ARTEO 2018” Sh.p.k për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Përzgjedhjes/ Kualifikimit, si më poshtë:

I. Nuk është përmbushur kriteri i pikës 2.1.1/ 2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, objekti i çertifikatës ISO 9001 nuk përmban objektin e prokurimit.

Për këto arsye, në zbatim të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), neni 80 pika 1, neni 87, dhe 92 pika 3 të tij, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) neni 40, 82 të tij, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) unanimisht vendosi të s’kualifikojë Operatorin Ekonomik pjesëmarrës, shoqërinë: “ARTEO 2018” Sh.p.k., pasi nuk përmbush kushtet dhe kërkesat e paraqitura në njoftimin e kontratës.

II.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton së më datë 24.12.2024 është Publikuar Njoftim Fituesi Paraprak i procedurës së prokurimit objekt- ankimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga ana e autoritetit kontraktor.

II.6. Në datën 26.12.2024, nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. A/2024/4930 dhe me nr. 3767/2024 prot, datë 26.12.2024, e operatorit ekonomik “Arteo 2018” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” me Nr. REF-31091-11-26-2024, me objekt “Blerje pajisje zjarrfikëse” me fond limit: 1,191,441 (një milion e njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e katërqind e dyzet e një) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 11.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mat. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Arteo 2018” SHPK me pretendimet si vijon:

Në datën 27.11.2024 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit Procedurë e Hapur e Thjeshtuar, me numër reference REF-31091-11-26-2024, me Objekt Blerje Pajisje Zjarrfikese, me fond limit 1.191.441,00 lekë pa TVSH, dhe datë zhvillimi 10.12.2024 ora 11:00 nga autoriteti kontraktor Bashkia Mat.

Më datë 13.12.2024, jemi njoftuar nëpërmjete SPE për klasifikimin e ofertave si me poshte vijon:

Operatoret Ekonomike	vlerat të ofertuara	Refuzuar
ARTEO 2018	1.061.000.00	Po
MBROJTJA DHE SHPËTIMI NGA ZJARRI	1.107.000.00	Jo

Oferta juaj OFFER-9454/20112024 per tenderin REF-28641-11-08-2024 me objekt mirëmbajtje e mjeteve të transportit viti 2024 (për nevoja të bashkisë mallakastër dhe NSHP) eshte refuzuar.

Arsyet:

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria Arteo 2018 Sh.p.k për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e Kërkuar në përputhje me Kriteret e vecanta të përzgjedhjes/ Kualifikimit, si më poshtë:

Nuk është përmbushur kriteri i pikës 2.1.1/ 2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë/ 2. Kriteret e vecanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, objekti i certifikatës ISO 9001 nuk përmban objektin e prokurimit. Për këto arsye, në zbatim të ligjit Nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik (i ndryshuar), neni 80 pika 1, neni 87, dhe 92 pika 3 të tij, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik (i ndryshuar) neni 40, 82 të tij, Komisioni i vlerësimit të Ofertave (KVO) unanimisht vendosi të s’kualifikojë Operatorin Ekonomik pjesëmarrës, shoqërinë: “Arteo 2018” Sh.p.k., pasi nuk përmbush kushtet dhe kërkesat e paraqitura në njoftimin e kontratës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria Arteo 2018 Sh.p.k për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e vecanta të përzgjedhjes/ Kualifikimit, si më poshtë: Nuk është përmbushur kriteri i pikës 2.1.1/ 2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë/ 2. Kriteret e vecanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, objekti i certifikatës ISO 9001 nuk përmban objektin e prokurimit. Për këto arsye, në zbatim të ligjit Nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik (i ndryshuar), neni 80 pika 1, neni 87, dhe 92 pika 3 të tij, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik (i ndryshuar) neni 40, 82 të tij, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) unanimisht vendosi të s’kualifikojë Operatorin Ekonomik pjesëmarrës, shoqërinë: Arteo 2018 Sh.p.k., pasi nuk përmbush kushtet dhe kërkesat e paraqitura në njoftimin e kontratës.

Me date 24.12.2024 eshte publikuar ne sistem afati per ankimim i procedures ne fjale.

Referuar skualifikimit tone nuk jemi dakort pasi Certifikata ISO 9001 e paraqitur nga ana jone, e permbush teresisht objektin e prokurimit ne fjale, ku pjese e aktivitetit (fushes) se saj jane dhe artikujt objekt i ketij prokurimi, ku percaktohet; Tregtim, furnizim e shpërndarje me

shumicë e pakicë të materialeve dhe pajisjeve industriale, elektrike, elektronike, automjeteve dhe pjesëve të këmbimit. Vleresojme te merrni parasysh sqarimet tona dhe te na kualifikoni si operatori ekonomik me oferten ekonomike me te vlefshme ne permbushje te kerkesave tuaja sipas DST.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 3767/2 prot., datë 27.12.2024 janë publikuar arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Arteo 2018” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 3767 prot, datë 26.12.2024.

II.8. Me shkresën nr. 4341/10 prot, datë 06.01.2025, protokolluar me tonën me nr. 3767/3 prot datë 06.01.2025 (ardhur nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike), dhe shkresën nr. 11 prot, datë 06.01.2025, protokolluar me tonën me nr. 3767/4 prot datë 08.01.2025 me objekt: “Dërgim Vendimi Nr. Prot.4341/10, datë 06.01.2025 për shqyrtimin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues “Arteo 2018” shpk” autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik, aktin e trajtimit të ankesës nr. 4341/10 prot, datë 06.01.2025 të operatorit ekonomik ankimues, nga verifikimii të cilit rezulton se ka vendosur mospranimin e ankesës me argumentimin si vijon:

Në piken 2.1.1/ 2.1 Kapacitetin profesional te Operatorëve Ekonomik, te Kriteve te Veçanta të Kualifikimit ne Shtojcën 8 te DST-së, eshte percaktuar kerkesa per kualifikim, si me poshte citojme:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën qe vërteton cilesine e menaxhimit te shoqërisë ISO 9001, e cila duhet te jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të procedures dhe objekti i saj të perputhet me objektin e prokurimit. Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma nderkombëtar akreditues te njohura nga Republika e Shqipërisë. Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomike, ISO-te duhen plotësuar nga secili anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë.

III.1.4 Bazuar ne dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues per pjesemarrje ne tender, rezulton se per permbushjen e kriterit të pikës 2.1.1/ 2.1 Kapacitetin Profesional të Operatorëve Ekonomik, të Kriteve te Veçanta te Kualifikimit, ka paraqitur ne sistemin e elektronik të prokurimeve (SPE) dokumentacionin/ Certifikatën e mëposhtem:

1. Çertifikate Nr.0213C2023, datë 09.02.2023 në emër te shogerise, “Arteo 2018” Sh.p.k., për çertifikimin sipas standartit ISO 9001: 2015 (Sistemi i menaxhimit të cilesisë) lëshuar nga trupi çertifikues “CERTIS CERTIFICATION INSTITUTE” (i akredituar) e vlefshme deri më datë 09.02.2026, për fushën e certifikimit citojme: “Tregtim, furnizim e shpërndarje me shumicë e pakicë të materialeve dhe pajisjeve industriale, elektrike, elektronike, automjeteve dhe pjesëve të këmbimit. Ndërtim, rikonstruksion i rrugëve, ndërtesave civile dhe industriale, ujësjellësve,

kanalizimeve, impianteve HVAC, hidrike, sigurisë, kaldajave, telefonisë dhe informatikes. Punime elektrike për shpërndarjen dhe transmetimin e energjise elektrike të TU, TM e TL”.

III.1.5 Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësive të operatorit për përmbushje me sukses të kontratës.

Ne varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatitin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Referuar kriterit të përcaktuar në pikën 2.1.1/ 2.1 Kapacitetin profesional të operatoreve ekonomikë, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit në Shtojcën 8 të DST-së, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) vëren se, autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të disponojnë dhe të paraqesin certifikatën që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë ISO 9001, e cila duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës dhe objekti i saj të përputhet me objektin e prokurimit, kërkesë kjo e cila është në përputhje dhe me parashikimet e dispozitave të LPP-se, dhe VKM-se për rregullat e prokurimit publik (cituat në pikën III.1.2). Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik ankimes “Arteo 2018” Sh.p.k., konkretisht certifikatën Nr.0213C2023, datë 09.02.2023 për certifikimin sipas standartit ISO 9001: 2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë), KSHA-ja konstaton se, fusha për të cilën është lëshuar kjo certifikatë nuk përmban tregtimin/furnizimin e materialeve dhe pajisjeve zjarrfikëse, pra, nuk përputhet me objektin e prokurimit, pasi objekti i prokurimit ka të bëjë me blerjen e pajisjeve zjarrfikëse, kërkesë kjo e cila është përcaktuar në pikën 2.1.1 (sipercituat). Në këto kushte, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) gjykon se operatori ekonomik “Arteo 2018” Sh.p.k., nuk e ka përmbushur kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 2.1.1/ 2.1 Kapacitetin Profesional të Operatoreve Ekonomikë, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit në Shtojcën 8, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa me sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron.

Për sa me sipër, në mbështetje të nenit 114 pika 3 germa “c” të ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik”, nenit 102 pika 1 germa “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), Komisioni i ngritur për shqyrtimin e Ankesës, unanimisht:

Vendosi:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Arteo 2018” Sh.p.k., për procedurën e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar – Mallra”, prokurim elektronik, me numër reference: REF-31091-11-26-2024, me objekt: “Blerje pajisje zjarrfikëse”, dhe me fond limit

në vlerën: 1,191,441 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 10.12.2024, ora: 11.00, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mat.

2. Një kopje e këtij vendimi t'i komunikohet Komisionit të Prokurimit Publik dhe operatorit ekonomik ankimues nga autoriteti kontraktor brenda dites së nesërme të punës nga marrja këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëhere.

II.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Arteo 2018” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: “*Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, Shoqëria “Arteo 2018” Sh.p.k për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Përzgjedhjes/ Kualifikimit, si më poshtë: Nuk është përmbushur kriteri i pikës 2.1.1/ 2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, objekti i çertifikatës ISO 9001 nuk përmban objektin e prokurimit. Për këto arsye, në zbatim të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), neni 80 pika 1, neni 87, dhe 92 pika 3 të tij, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) neni 40, 82 të tij, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) unanimisht vendosi të s’kualifikojë Operatorin Ekonomik pjesëmarrës, shoqërinë: “Arteo 2018” Sh.p.k., pasi nuk përmbush kushtet dhe kërkesat e paraqitura në njoftimin e kontratës” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.1.1 “Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikatën që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë ISO 9001, e cila duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës dhe objekti i saj të përputhet me objektin e prokurimit. Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

III.1.2. Në shtojcën 7 “Formulari i Sasisë dhe Grafikut të Lëvrimit” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

1	2	3	4
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Njësia	Sasia
1.	Tub gome 20 m	copë	4
2.	Gurë fresibël	copë	1
3.	Motorrsharrë shine	copë	1
4	Tubë për luftim zjarri me kokë 50 mm	copë	18
5.	Çelës hidraulik	copë	2
6.	Çelës hapje tubash ZF	copë	4
7.	Lopata 4 <i>copë</i> , kazëm 4 <i>copë</i> , sopatë 2 <i>copë</i>	set	4
8.	Litarë të ndryshëm për zbritje dhe shpëtim	metër	50
9.	Hedhës uji (Pistoletë) diameter 50 mm	copë	1
10.	Fikëse zjarri 9 litër me shkumë	copë	4
11.	Fikëse zjarri 9 litër me pluhur	copë	4
12.	Aparat frymëmarrje	copë	2
13.	Çizme kundra zjarrit	palë	4
14.	Pompa shpine	copë	10
15.	Doreza kundra zjarrit	copë	4
16.	Elektrik me karikim në kasketë	copë	10
17.	Leva të ndryshme për hapje konstruksionesh	copë	4
18.	Zvogëlues lidhësesh të tubave për luftim zjarri (përshtatës)	copë	2
19.	Gërshëre për prerje hekurash	copë	2

Afatet e lëvrimit:

Lëvrimi i mallrave/ artikujve objekt prokurimi, do të bëhet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e lidhjes së kontratës, në magazinën e A.K. Bashkisë Mat, me mjetet e furnizuesit.

III.1.3. Në Seksionin 2 “Objekti Kontratës” pika 2.2 “Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP)”, të dokumentave standarte të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kodet si më poshtë vijon:

2.2 Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 14811200-1 Gurë mprehës, 18815000-5 Çizme, 42122000-0 Pompa, 44511500-0 Sharra dora, 44512500-7 Çelësa.

III.1.4. Në Procesverbalin për Argumentimin dhe Miratimin e Spcifikimeve Teknike dhe Kriterëve për Kualifikim, të procedurës së prokurimit objekt ankimi të publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, autoriteti kontraktor ka argumentuar si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë ISO 9001, e cila duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës dhe objekti i saj të përputhet me objektin e prokurimit. Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomike, ISO-t duhen plotësuar nga secili anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” (i ndryshuar) në të cilët përcaktohet se, citojmë:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;... 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.”

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Gjithashtu në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të

drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. 2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37, të LPP-së. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, njësia e prokurimit gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së mallit/ produktit objekt prokurimi në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së mallrave/artikujve që kërkohet të kryhet furnizimi i tyre, njësia e prokurimit ka kërkuar certifikatën e mësipërme për vërtetimin se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këtë mall (ka të bëjë me parimet e produkteve, duke filluar nga faza e projektimit, prodhimit dhe shitjes së produktit/ materialit) duke i dhënë besimin e plotësimit të kërkesave të cilësisë për mallin/ produktin blerësit (Autoritetit Kontraktor).

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet profesionale si më lart, duke qënë se këto kriteret janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e marrëveshjes kuadër. Por edhe sepse mbi të gjitha ato i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale të operatorëve ekonomikë, besueshmërisë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

III.1.5. Në përmbushje të kriterit më sipër operatori ekonomik “Arteo 2018” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE dokumentacionin si më poshtë:

- Certifikatën ISO 9001:2015, nr. 0213C2023, datë 09/02/2023, lëshuar nga organizmi certifikues “Certis”, për shoqërinë “Arteo 2018” SHPK, për fushën “Tregtim, furnizim e shpërndarje me shumicë e pakicë të materialeve dhe pajisjeve industriale, elektrike, elektronike, automjeteve dhe pajisjeve të këmbimit. Ndërtim, rikonstruksion i rrugëve, ndërtesave civile dhe industriale, ujësjellsave, kanalizimeve, impianteve HVAC, hidrike, sigurisë, kaldajave, telefonisë dhe informatikës. Punime elektrike për shpërndarjen dhe transmetimin e energjisë elektrike të TU, TM e TL”, me afat vlefshmërie deri në datën 09/02/2026

III.1.6. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.7. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.8. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së, i ndryshuar, përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.9. Në nenin 79, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:

a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;

b) efikasitetit të energjisë;

c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara.

4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

III.1.10. Ndërsa në nenin 40 “Kërkesat e veçanta për kontratat e mallrave”, pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve..”

III.1.11. Në nenin 44 “Kërkesa e cilësisë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “

1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e

kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një 30 mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37 të LPP-së. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

3. Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, si dhe çdo operator ekonomik duhet të ketë akses në to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

4. Nëse autoriteti/enti kontraktor kërkon një certifikatë ose etiketë, ata janë të detyruar të pranojnë çdo certifikatë ose etiketë ekuivalente/të barasvlershme me të ose një dokument që provon të njëjtin informacion.

5. Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.”.

III.1.12. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 457, datë 30.7.2021 “Për miratimin e fjalorit të përbashkët të prokurimit” përcaktohet se:

FJALORI I PËRBASHKËT I PROKURIMIT

LISTA E KODEVE CPV

Shpjegime dhe përshkrime: Fjalori i Përbashkët i Prokurimit është i bazuar në një strukturë bazë, që përfshin kode deri në nëntë shifra, të shoqëruara me një formulim që përshkruan mallrat, punët ose shërbimet, të cilat janë objekt i një procedure prokurimi. Në çdo rast, për zhvillimin e një procedure prokurimi, autoritetet ose entet kontraktore duhet të përzgjedhin detyrimisht në sistemin e prokurimit elektronik një prej kodeve të përcaktuara që i korrespondon objektit konkret të prokurimit. Kodi numerik përbëhet nga 9 shifra, të ndara si më poshtë: - dy shifrat e para identifikojnë ndarjet (XX000000-Y); - tri shifrat e para identifikojnë grupet (XXX00000-Y); - katër shifrat e para identifikojnë klasat (XXXX0000-Y); - pesë shifrat e para identifikojnë kategoritë (XXXXX000-Y). Secila prej tri shifrave të fundit ofron një shkallë më të madhe saktësie brenda secilës kategori. Shifra e nëntë shërben për të verifikuar shifrat e mëparshme

KODI CPV EMËRTIMI I KODIT CPV

14811200-1 / Gurë mprehës

18815000-5 / Çizme

42122000-0 / Pompa

44511500-0 / Sharra dora

44512500-7 / Çelësa

III.1.13. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike janë lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.14. Në rastin konkret, referuar dosjes së tenderit, në seksionin 2 Objekti i Kontratës pika 2.2 “*Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP)*” autoriteti kontraktor ndër të tjera ka përcaktuar: “**14811200-1** Gurë mprehës, **18815000-5** Çizme, **42122000-0** Pompa, **44511500-0** Sharra dora, **44512500-7** Çelësa”. Në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, në seksionin “Të tjera”, në rubrikën “Kodet CPV” përcaktohen grupi i kodeve, emërtimi i kodit CPV dhe Identifikimi i kodit CPV për procedurat e prokurimit elektronik. Sa më sipër, në grupin e kodeve “Produkte të minierave, metaleve bazike dhe të lidhura me to” bën pjesë emërtimi i kodit **14811200-1** dhe identifikimi i kodit Gurë mprehës, në grupin e kodeve “Veshje, këpucë, artikuj valixhesh dhe aksesore” bën pjesë emërtimi i kodit **18815000-5** dhe identifikimi i kodit Çizme, në grupin e kodeve “Makineri industriale” bën pjesë emërtimi i kodit **42122000-0** dhe identifikimi i kodit Pompa, dhe në grupin e kodeve “Materiale ndërtimi dhe produkte ndihmëse për ndërtimin” bën pjesë emërtimi i kodit **44511500-0**, **44512500-7** dhe identifikimi i kodeve Sharra dora dhe Çelësa që përputhet me kodin CPV të procedurës së prokurimit dhe me objektin e veprimtarisë për të cilën është lëshuar certifikata EN-ISO 9001:2015 për operatorin ekonomik “Arteo 2018” SHPK, pasi objekti i veprimtarisë së certifikatës të sipërcituara ndër të tjera përfshin dhe tregtimin e produkteve industriale. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se arsyeja e skualifikimit për operatorin ekonomik ankimues nuk qëndron, pasi certifikata ISO 9001:2015 e paraqitur nga ana e operatorit ekonomik ofertues “Arteo 2018” SHPK e plotëson kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën

2.1. *“Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë”* të shtojcës 8/2, *“Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”*, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, pasi në fushën e aktivitetit të kësaj certifikate është i përfshirë objekti i prokurimit, pasi referuar kodit CPV të përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor në pikën 2 të Seksionit 2 *“Objekti i Kontratës”* të dokumentave të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit, si dhe objektit të kësaj certifikate ku ndër të tjera përfshihen materiale dhe pajisje industriale përputhet me objektin e prokurimit të kësaj procedure prokurimi, si dhe me zërat e parashikuar nga autoriteti kontraktor në shtojcën 7 *“Formulari i Sasisë dhe Grafikut të Lëvrimit”* pasi zërat të cilat kërkon të prokurojë autoriteti kontraktor janë të ngjashëm me objekt prokurimi pra bëjnë pjesë në fushën e materialeve dhe pajisjeve industriale. Në rastin konkret, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik kryen aktivitetin objekt-prokurimi sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare, vërtetuar kjo nëpërmjet paraqitjes të certifikatave si ISO 9001: 2015. Në këto kushte KPP gjykon, se operatori ekonomik *“Arteo 2018”* ShPK plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.1.1 *“Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë”* të shtojcës 8/2 *“Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”* të dokumentave standarte të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se përfituesi i drejtpërdrejtë i objektit të prokurimit është vetë autoriteti kontraktor dhe si i tillë ai ka një pozitë të veçantë dhe është përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kontratës sipas legjislacionit në fuqi, kjo bazuar në nenin 124 të LPP-së ku përcaktohet se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të ndjekë zbatimin e kontratës sipas kushteve në bazë të të cilave është nënshkruar, për të garantuar se ajo zbatohet në kohën, cilësinë dhe vlerën e përcaktuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe me legjislacionin në fuqi. 2. Për monitorimin e zbatimit të kontratës, autoriteti ose enti kontraktor, nisur nga natyra e objektit të kontratës dhe kohëzgjatja e zbatimit të saj, harton planin e zbatimit të kontratës, duke përfshirë në veçanti çështjet organizative, afatet, çështjet ekonomike e teknike të kontratës së nënshkruar, në përputhje me çdo akt tjetër ligjor. 3. Plani i zbatimit të kontratës duhet të nënshkruhet nga autoriteti ose enti kontraktor dhe operatori ekonomik brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe në çdo rast para fillimit të zbatimit të saj. 4. Çdo modifikim i kontratës në përputhje me nenin 127 të këtij ligji, pasqyrohet në planin e zbatimit. 5. Autoriteti ose enti kontraktor, në përputhje me planin, ndjek zbatimin e kontratës, administron dokumentacionin e monitorimit dhe harton raportet e monitorimit. 6. Rregulla të hollësishme për monitorimin e zbatimit të kontratave, sipas tipologjive të tyre, përcaktohen nga rregullat e prokurimit publik. Autoriteti kontraktor duhet të kryejë pagesat në favor të operatorëve ekonomikë, në përputhje me parashikimet e legjislacionit të fushës në fuqi.”* Pra është autoriteti kontraktor si organi me interes dhe përgjegjësi për realizimin me sukses të kontratës, është pikërisht ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës për t’u siguruar nëse cilësia e automjeteve të kërkuar në dokumentat e tenderit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Sa më lart, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik *“Poëer Industries”* ShPK për përmbushjen e kriterit 2.1.1 do të konsiderohet i rregullt, duke plotësuar kështu këtë kriter të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit.

Sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Arteo 2018” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Arteo 2018” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” me Nr. REF-31091-11-26-2024, me objekt “Blerje pajisje zjarrfikëse” me fond limit: 1,191,441 (një milion e njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e katërqind e dyzet e një) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 11.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mat.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Arteo 2018” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Arteo 2018” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

